

Portugalia kalon ne gjysemfinale

nga Administrator

E premte, 01 Korrik 2016 09:35



Ekipi i Portugalise ka arritur te kualifikohet per ne gjysem-finale te kampionatit europian France 2016. Ekipi i Cristiano Ronaldo, ka fituar me penallti kunder ekipit te Levandovskit, Polonise. Polaket e kane filluar mire ndeshjen duke kaluar ne avantazh ne minuten e 2 te ndeshjes me ane te sulmuesit kryesor te tyre Levandovski. Portugalia e shokohet nga ky gol i shpejt dhe e ka te veshtire te dale perpara, ku polaket do te shfaqeshin disa here te rrezikshem para portes. Ne minutat ne vazhdim, Portugalia fillon e te çlirohet dhe talentet qe ka ne ekip fillojne e te kerkojne golin e barazimit i cili do te vije ne minuten e 33 me ane te 18-vjeçarit Sanches. Pjesa e pare mbyllet ne barazim 1-1.

Ne pjesen e dyte te dy ekipet kerkojne golin e avantazhit por nuk ja arrin dot, keshtu qe ndeshja shkon ne shtese dhe me pas do ti vije rradha penalltive.

Ai qe do te humb penalltine do te jete Blazhikovski, dhe me pas Quaresma do te shenoje penalltine e fitores duke kaluar Portugaline ne gjysem-finale.

Sonte do te luhet çerekfinalja tjeter mes Uellsit dhe Belgjikes.